



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 9 shtator 2019.
2. Seancë dëgjimore me Shoqatën e Botuesve Shqiptarë në lidhje me problemet që shqetësojnë sektorin e librit në Shqipëri.
3. Diskutimi i kalendarit të punës së Komisionit.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Fadil Nasufi, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ramazan Gjuzi, Kostaq Papa, Selami Jehnishehri dhe Amra Barova.

Mungojnë:

Vilma Bello, Enada Kapllani, Klajdi Qama.

Të ftuar:

Petrit Ymeri – kryetar i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë,
Gëzim Tafa - përfaqësues nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë,
Elira Dani – drejtore e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Kulturës,
Kozeta Angjeliu – drejtore e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës,
Nikolla Lera - drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 9 shtator 2019.

Nëse nuk ka kundërshtime apo diskutime për procesverbalin, miratohet.

Milva Ekonomi – Më falni, zonja kryetare, unë kam bërë dy-tri korrigjime të vogla dhe do t'ia kaloj Arianës.

Fatjona Dhimitri – Dakord!

Sot në rendin e ditës është parashikuar seanca dëgjimore me Shoqatën e Botuesve Shqiptarë për problemet që shqetësojnë sektorin e librit në Shqipëri. Të ftuar nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë kemi zotin Petrit Ymeri dhe zotin Gëzim Tafa.

Mirë se erdhët!

Nga Ministria e Kulturës kemi të ftuar zonjën Elira Dani nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe zonjën Kozeta Angjeliu, drejtoreshë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Kulturës.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi të ftuar zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm në ministri.

Nga Shoqata e Botuesve na është vënë në dispozicion letra e dërguar Kryetarit të Kuvendit dhe Ministrisë së Financave për problematikat që i shqetësojnë.

Jemi në dispozicion t'ju dëgjojmë për problematikat tuaja.

Fjalën e ka zoti Ymeri.

Urdhëroni!

Petrit Ymeri – Faleminderit!

Me thënë të drejtën, ne kemi kërkuar interpelancë me ministren e Arsimit, me ministren e Kulturës, si dhe me ministren e Financave. Kryesisht me Ministrinë e Financave i kemi gjërat të qarta, sepse kemi bërë dy-tri takime deri tani, por mua nuk më duket normale që në një takim të tillë, të mos jenë të pranishëm titullarët e këtyre ministrive.

Me gjithë respektin për përfaqësuesit, Ministria e Arsimit, siç e dini, nuk ka dërguar asnjë njeri.

Fatjona Dhimitri - Me sa jam në dijeni, zoti Ymeri, në një seancë tjetër dëgjimore ndoshta do të jetë e pranishme ministrja e Arsimit ose përfaqësues të ministrisë. Kështu është vendosur me shumicë votash në komision.

Petrit Ymeri - Dakord.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Petrit Ymeri – Nëse e keni lexuar letrën tonë, ne aty kemi shfaqur problemet kryesore se ku çalon çështja e librave. Është kryesisht në sektorin e arsimit, ndaj them se do të ishte shumë mirë të kishim një përfaqësim të nivelit të titullarëve. Ndoshta nëse bëhet kjo që thoni ju, do të ishte mirë.

Nëse e keni lexuar letrën tonë, ne do të preferonim të kishim pyetjet apo shqetësimet tuaja dhe, më pas, të përgjigjeshim ose të diskutonim. Nuk e di si e keni menduar ju, sepse gjërat kryesore ne i kemi parashtruar në letrën tonë. Mendoj se kështu do të jetë më mirë.

Fatjona Dhimitri – Dakord.

Mund të vazhdoni t'i trajtoni ju problematikat tuaja fillimisht.

Petrit Ymeri – Jo, ne i kemi paraqitur problemet kryesore.

Domethënë, kemi dy rrafshë:

Problemi i parë është sektori libror në Shqipëri, sistemi bibliotekar, sistemi libror, marrëdhëniet e librit me shkollën dhe me pushtetin lokal.

E dyta, kemi disa kërkesa për amendime në ligjin e të drejtës së autorit dhe në ligjin e librit.

Mendoj të dëgjojmë pyetjet tuaja, sepse ne i kemi shkruar çfarë kemi pasur për të thënë.

Fatjona Dhimitri - Zoti Ymeri, cila është gjendja e bibliotekave të qyteteve dhe e Bibliotekës Kombëtare në Shqipëri?

Petrit Ymeri – Unë jua thashë, por me sa duket, nuk po kuptohemi.

Ne i kemi parashtruar gjërat kryesore në letrën tonë.

Me dy fjalë po e them se rrjeti i bibliotekave në shkolla është shumë i dobët, shumë i varfër. Në Shqipëri ka pasur një aksion, ta quajmë shumë të mirë, në fillim të viteve 2000, që u bë nëpërmjet UNICEF-it, një projekt i madh disavjeçar “Shqipëria lexon”, sigurisht, me iniciativën e qeverisë shqiptare.

Më pas u bënë disa furnizime për 4-5 vjet me radhë nga viti 2006 deri në vitin 2012. Në vitin 2012 ka qenë furnizimi i fundit i bibliotekave shkollë, më pas nuk ka pasur më furnizime masive.

Vitin e kaluar janë vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit 20 milionë lekë të rinj, 18 milionë nga të cilat u dogjën, pra nuk u përdorën. U përdorën vetëm 2 milionë lekë të rinj në bibliotekat e shkollave të Lezhës.

Për 3 vjetët 2019, 2020 dhe 2021 në buxhetin e shtetit janë parashikuar 10 milionë lekë. Vitit 2019 po i afrohet fundi dhe nuk është shpenzuar asnjë qindarkë deri tani, ndaj thashë që

duhet të bisedojmë me Ministrinë e Arsimit. Kemi pasur takime me ta dhe, të them të drejtën, kemi pasur mirëkuptimin e zonjës Lindita Nikolla, të cilën e kemi takuar disa herë dhe jemi përpjekur të kuptojmë arsyet e njëri-tjetrit. Kemi pasur takim më vonë edhe me zonjën Shahini, kur ka qenë zëvendësministre, e cila ka qenë e ngarkuar me ndjekjen e projektit të furnizimit të shkollave në vitin 2018, që dështoi. Për këtë vit nuk kemi asnjë.

Kemi kërkuar ngritjen e një bordi për përzgjedhjen e titujve, një punë zyrtare, siç e kërkon rregulli, por nuk është bërë asgjë nga këto. Domethënë, kemi një mungesë komunikimi me Ministrinë e Arsimit.

Marrëdhëniet e librit me shkollën janë shumë të vështira për botuesit. Shkollat janë kthyer në një lloj bunkeri, ku mund të hyhet vetëm me leje të veçanta, në një kohë kur ne kërkojmë një bashkëpunim, që të jetë në dobi të të dyja palëve. Sigurisht, libri pa shkollën është i mbaruar, por edhe shkolla pa librin, gjithashtu.

Çështja e bibliotekave lokale është një problem më vete, sepse, sipas ligjit të pushtetit lokal, kjo është në kompetencën e tyre. Ne, së bashku me Ministrinë e Kulturës, duke biseduar edhe me zonjën Kumbaro, jemi përpjekur disa herë dhe e kemi kuptuar ngërçin që është në ligj lidhur me këtë çështje. Megjithatë, ne jemi të mendimit që administrata shtetërore mund të futet me projekte të përcaktuara qartë për bibliotekat e pushtetit lokal, që, sigurisht, janë shumë të varfra. Duhet të kemi parasysh që 70% apo 80% e popullsisë nuk është në gjendje të blejë libra dhe është detyrim i shtetit të furnizojë bibliotekat publike të qyteteve, duke filluar nga librat shkollorë dhe të tjerë. Nuk po flas pastaj për bibliotekat e fshatrave, sepse kjo duket si një ëndërr e vjetër. Gjithashtu, edhe rrjeti i librarive është shumë i varfër, edhe libraritë. Libraritë po mbyllen gjithnjë e më shumë, pasi mungojnë politikat stimuluese dhe favorizuese si nga pushteti lokal, ashtu edhe nga pushteti qendror.

Po kaloj te sistemi fiskal dhe po i prek ato, që ju i keni të shkruara në letër. Përgjithësisht, sistemi fiskal ka qenë i paqëndrueshëm dhe goditës ndaj librit, me ndryshime dhe luhatje ndonjëherë të nxituara. Kemi pasur një rritje të tatimit të fitimit në vitin 2014, një rritje tatimi për honoraret e kryera në vitin 2014, kemi pasur ndryshime në ligjin për TVSH-në në janar të vitit 2019, që, siç e dini, është një nga ligjet themeltare të sistemit fiskal, të cilin e konsiderojmë pozitiv, meqenëse ky ligj funksionon si rregullator në mbështetje të veprimtarive profesionale dhe kundër evazionit fiskal. Disa gjëra nga këto janë të vjetra, sepse kuptohet që kjo letër është bërë shumë muaj përpara, në muajin maj të vitit 2019. Gjithashtu, nga ministrja e Ekonomisë dhe Financave na është bërë një vërejtje për pasqyrimin e 6%-shit të TVSH-së në shitjen e librave shkollorë. Unë nuk e di si është rregulluar më pas kjo gjë në shitjen e librave shkollorë, por di që zonja ministre i ka dërguar një letër Ministrisë së Arsimit.

Gjithashtu, ne kemi ngritur disa herë problemin për fotokopjet masive që bëhen në universitetet shtetërore dhe private, si dhe për përdorimin lirisht të teksteve të fotokopjuara në ambientet mësimore universitare. Sigurisht, vërejtjet tona janë shoqëruar me heshtje qoftë nga universitetet, qoftë edhe nga institucionet e specializuara, që duhet të merren me këtë problem.

Gjithashtu, kemi pasur një kontradiktë me ISHMT-në, që besoj se tani është tejkaluar. Ka pasur një qëndrim agresiv nga ana e tyre, por ne u dhamë sqarimet e duhura qoftë nëpërmjet korrespondencës, qoftë edhe me takime direkt me përfaqësues të Ministrisë së Financave.

Siç e vini re në letër, ne kemi bërë disa propozime për të përmirësuar sistemin fiskal, edhe në dy ligje të tjera.

Së pari, ne kemi kërkuar të ulet tatimi për krijimtarinë letrare dhe artistike në nivelin e TVSH-së së librit, pra të ulet në nivelin e 6%-shit. Për dijeninë tuaj, shumë vite më parë tatimi për krijimtarinë letrare dhe artistike ka qenë 5%, më pas është bërë 10% dhe në vitin 2014 është bërë 15%. Kjo kategori krijuesish që preken nga ky tatim për honoraret, i përket shtresës më vulnerable, që e ndjen shumë këtë tatim. Pra, ne mendojmë se atyre u duhet dhënë një ndihmë, sepse nuk besoj se ka ndonjë efekt shumë të madh në buxhet. Për shembull, në qoftë se është një honorar 100 mijë lekë të rinj, me 15% i bie që të mbahen 150 mijë lekë dhe kjo është një shifër shumë e lartë.

Ne kemi propozuar edhe disa rregullime të vogla në ligjin “Për të drejtën e autorit”, si dhe në statusin e të drejtave të autorit në Ministrinë e Kulturës, duke marrë si shembuj disa agjenci dhe drejtori për mënyrën se si ato funksionojnë kudo në botë, si institucione të pavarura jopublike, por që mbahen me fonde publike. Ne kemi kërkuar një ndryshim në nenin 60, pika 3, të ligjit “Për të drejtën e autorit”, të cilën e kemi depozituar. Gjithashtu, kemi kërkuar të ndryshohet një nen në ligjin aktual “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, për kopjen e detyruar për Bibliotekën Kombëtare nga 5 të bëhet 1. I kam radhitur sipas praktikës, sipas shembujve historikë dhe shembujve aktual se si funksionon kudo në botë. Ne jemi në nivelin e Afrikës së Jugut dhe të Rusisë me 5 kopje. Shumica e vendeve europiane kanë nga një kopje, me përjashtim të atyre vendeve që kanë më shumë se një Bibliotekë Kombëtare. Arsyetimi është në listën përkatëse.

Kemi një problem që po zgjatet prej shumë vitesh, nuk e di se si mund të rregullohet çështja e praktikave doganore me Republikën e Kosovës për futjen dhe daljen e librit. Janë gjëra që i kemi diskutuar edhe me Ministrinë e Kulturës, edhe me financat, pra duhet një vullnet që të rregullohet kjo punë, nëse mundet.

Bëra një riepilogim të çështjeve që kemi trajtuar në letrën që i kemi drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, komisionit tuaj, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Kulturës dhe të Arsimit. Nëse keni pyetje, mund t'ju përgjigjem me shumë kënaqësi.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Ymeri!

Zoti Tafa, dëshironi të thoni diçka?

Gëzim Tafa – Përgjithësisht problematikat i trajtoi zoti Ymeri, por unë kam përf forcime në dy pika serioze. E para, është kopja e detyruar për bibliotekat, e cilat ka një impakt të rëndësishëm financiar te shtëpitë botuese, sepse duhet kuptuar se janë kopje që dorëzohen në Bibliotekë Kombëtare, por reflektohen në inventarin e shtëpisë botuese. E dyta, ndryshimi i nenit për depozitim të kontratës, ku flitet që kontrata fillon mbas depozitimit në zyrën e të Drejtave të Autorit. Mbase certifikimi është i panevojshëm për ta bërë këtë gjë; zoti Ymeri e trajtoi.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Tafa!

Po, urdhëroni!

Milva Ekonomi – Përpara se të vazhdojmë më tej me diskutimet, në këtë komision është bërë traditë që kur nis viti i ri shkollor, zonja Adelina Rista hap mbledhjen e komisionit duke bërë një urim. A do ta bësh urimin, Adelina, edhe për këtë vit të ri shkollor?

Adelina Rista – Dje në të gjithë Republikën e Shqipërisë kanë hapur dyert të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar publik dhe jopublik. Një armatë e tërë fëmijësh në të gjithë republikën u dyndën drejt dyerve të shkollave për të marrë dhe për t'u pasuruar me dije.

Kjo është një ditë e bukur për çdo familje shqiptare. E vetmja gjë unike që çdo familje ka, është lidhja me arsimin direkt ose indirekt, sepse, edhe nëse nuk kanë fëmijë, kanë nipër, mbesa dhe të afërm. Pra, të gjithëve na dhemb arsimi dhe të gjithë e duam arsimin.

Prandaj, si qytetare e Republikës së Shqipërisë, si prind që kam rritur dhe edukuar fëmijët në shkollat e Shqipërisë, si një ish-mësuese e vjetër me përvojë në auditorët e shkollave shqiptare, si një arsimtare që kam dhënë kontributin tim edhe në drejtimin e arsimit në rreth, në instancat më të larta, si një parlamentare, sot deputete dhe anëtare e Komisionit të Edukimit, që mbulon edhe arsimin, dua t'u uroj të gjithë fëmijëve që u dyndën drejt dyerve të shkollave suksese, suksese, suksese!

Të gjithë mësuesve që japin kontributin e tyre dua t'u them dy fjalë, në emrin tuaj kolegë. Mësuesia është profesion i bukur, por sa i bukur është, po aq dhe i vështirë; por sa i vështirë është, po aq edhe fisnik, sepse ka në duar çelësin e edukimit të brezit të së ardhmes.

Prandaj të gjithë mësuesve unë u uroj që të jenë model frymëzimi dhe shembull i mirë për t'u ndjekur nga të gjithë nxënësit e tyre.

Dua t'i uroj Ministrisë së Arsimit dhe qeverisë shqiptare që ka bërë aq shumë për reformimin e arsimit, suksese në këtë rrugë ku është futur arsimi shqiptar. Dua të uroj që atë nismë që qeveria shqiptare ka marrë për dhënien e librave falas, deri në fund të mandatit, ta çojë deri në klasën e 9-të.

Suksese fëmijëve që morën librat falas!

Suksese atyre që hynë për herë të parë në shkollë!

Suksese të gjithë maturantëve!

Suksese mësuesve, suksese kolegëve!

Suksese Ministrisë së Arsimit dhe qeverisë shqiptare!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja Rista!

Në fakt, duhet ta kisha nisur mbledhjen me këtë urim, pavarësisht se kalova direkt në çështjen e parë të rendit të ditës, dëgjësë me Shoqatën e Botuesve.

Nxënësve dhe të rinjve shqiptarë kurrë nuk ka për t'u munguar urimi im për fillimin e vitit të ri shkollor dhe sa më shumë suksese!

Ditën që ne do të kemi seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, do të flasim për të parë se si është gjendja e arsimit në shkollat shqiptare.

Faleminderit!

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Duke falënderuar kolegen Rista po i kthehem temës së ditës.

Falënderoj zotin Ymeri dhe zotin Tafa për prezencën dhe për raportimin që ata bënë! Në të njëjtën kohë, këtë e kam më shumë për kolegët e mi të komisionit, pasi më vjen keq që një kërkesë për dëgjësë, e cila është bërë që në maj ia gjejmë kohën në shtator, por më mirë vonë se kurrë.

Unë i bashkohem Shoqatës së Botuesve, e cila shpreh shqetësimin për situatën në të cilën ndodhet libri, jo thjesht libri si mall, duke mirëkuptuar edhe interesat krejt të natyrshme të botuesve lidhur me librin, i cili gjatë botimit has vështirësi si kostoja dhe çmimi i lartë, që është i sfiduar fort nga teknologjia e kohës dhe kjo nuk është shqiptare, por mbarëbotërore, duke u përballuar me shumë vështirësi dhe për këtë jam shumë e ndërgjegjshme.

Shqetësimi im më i madh lidhet me diçka që shkon përtej librit, me edukimin për leximin si një aktivitet emancipues, arsimues, social, si një aktivitet që zbut efektet sociale të një ekonomie të vështirë apo të zonave ku ka varfëri. Këtë, sigurisht, nuk mund ta bëjnë

individët, familja dhe vetë botuesit, në qoftë se shteti dhe aktorë të rëndësishëm të shoqërisë, jo vetëm shteti dhe për këtë arsye i theksova edhe aktorët e tjerë që nga shoqëria civile, por edhe vetë botuesit, me mekanizma, të cilët duhet ta çojnë më tej aktivitetin e leximit. Pastaj, nëse lexohet në letër apo në suport elektronik kjo është çështje epoke. Dikur lexohej dhe shkruhej në pllakat e gurit, është vetëm teknologjia ajo që evolon.

Mua më shqetëson fakti se ne kemi një deficencë shumë të madhe, e cila nuk është e një dite, e një viti apo e një mandati, por është e 30 vjetëve tranzicion, sepse nuk është vënë gishti në plagë dhe kur nuk e vë gishtin në plagë për 30 vjet, sigurisht neve, si maxhorancë, na bie barra të marrim edhe përgjegjësinë e gjërave të pabëra këto 30 vjet dhe të përpiqemi të ndërtojmë, qoftë për të kompensuar aq sa është e mundur, sepse nuk mund t'i kompensosh kollaj gjithë këta vjet, por edhe për të ndërtuar për të ardhmen një mekanizëm.

Nëse kemi humbur të paktën 3 gjenerata lexuesish, 3 gjenerata publiku të arteve të tjera, të kulturës, jo thjesht për kënaqësi estetike, por për domosdoshmëri emancipimi, sepse nuk mund të bëhet emancipimi vetëm me investime në rrugë dhe në ndërtesa, kjo kërkon politika, të cilat, më lejoni t'ju them, meqë e njoh këtë sektor, kanë filluar të ndërtohen, por e pranoj që janë të pamjaftueshme. Edhe në kohën kur kam qenë ministër, e kam theksuar faktin që te ne nevoja për lexim dhe edukim përmes kulturës është emergjencë kombëtare.

Edhe sot, në fakt, ne kemi një dëshmi të kësaj emergjence. E lexova me shumë vëmendje letrën e Shoqatës së Botuesve dhe jam dakord me shumë prej konstatimeve të tyre, të cilat në 5 vjet e gjysmë në krye të Ministrisë së Kulturës i kemi ndarë. Ju nuk e mohuat, por më vjen natyrshëm t'ju them, sepse e prisja më të theksuar, që në derën e Ministrisë së Kulturës në këto 5 vjet e gjysmë keni gjetur njerëz me të cilët keni komunikuar në të gjitha format, qoftë në formë tryezash të rrumbullakëta, konferencash, *e-mail*-e formale apo informale. Që nga specialisti më i thjeshtë dhe deri te ministri kanë qenë ndër dëgjuesit më të vëmendshëm sa i takon librit, pasi e kemi konsideruar veten deri diku bashkëvuajtës të situatës që ju përshkruani.

Sigurisht, konstatimi që ne bëjmë sot i librarive të munguara është konstatim i një pasoje 30-vjeçare, së cilës nuk ia del dot as vetë botuesi dhe as Ministria e Kulturës, por duhet patjetër që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me Ministrinë e Kulturës dhe të Arsimit, pra, është koha që më shumë se kurrë të vendosen mekanizma, që janë më së shumti financiarë-stimulues, siç mund të jetë bërë për bizneset, ashtu siç kemi bërë për turizmin, sepse është një degë shumë e rëndësishme e zhvillimit të ekonomisë, siç mund të bëjmë për të tërhequr investimet e huaja, sepse tashmë po ia paguajmë shumë rëndë pasojat kësaj politike të munguar mbi 25 vjet nëpër shkolla, gazetari e të tjera, duke konstatuar nivelin e dobët, jo

thjesht të shkrimit të gjuhës shqipe. Ajo që mua më shqetëson më shumë është niveli i ulët i emancipimit, i cili vjen edhe si pasojë e kësaj mungese.

Kjo është arsyeja pse politikat e nisura nga Ministria e Kulturës, që nxisin të gjitha format, nuk mund të përçmohen absolutisht në asnjë lloj forme, që nxit sadopak leximin në një fshat, në një klasë, në një shkollë. Kjo nuk është diçka që bëhet me një urdhër, është një gjë që bëhet me punë të përditshme nga të gjithë. Nuk e bën dot as vetëm ministria. Ne duhet të përfshihemi të gjithë, madje na kanë kërkuar ndihmë edhe nga kolegët e opozitës, por e kanë konsideruar dhe këtë si një akt politik. Çështja e emancipimit të shoqërisë është çështje që nuk prek vetëm një shoqëri, po prek të ardhmen e fëmijëve tanë. Nëse ne nuk punojmë për të ardhmen e fëmijëve tanë, na hëngërt mortja me gjithë politikën.

Ajo që dua të them është që ky është një ligj i rëndësishëm. Mua më erdhi mirë që kenë zgjidhur problemet edhe me ISHMT-në qoftë edhe deri diku. Unë po e them direkt që nuk jam dakord me ndryshimin e nenit që ju përmendët, se ky ligj, në fakt, ka synim dhe filozofi qendrore që të mbrojë kategorinë më vulnerabël në sektorin e të drejtave të autorit që janë krijuesit. Ata janë viktima e madhe e këtij tranzicioni të gjatë, viktima e madhe e një historie pararendëse të munguar në fushën e të drejtave të autorit. Regjimi i kaluar nuk e kishte nocionin e të drejtave të njeriut, lëre pastaj të të drejtave të autorit. Në këtë kontekst ne kemi breza të tërë edhe të arteve të tjera, por sidomos të shkrimtarët apo të përkthyesit, apo të trashëgimtarët e shkrimtarëve apo të përkthyesve, vepra të të cilëve botohen e ribotohen pa fund në versione të mira nga botues cilësorë, siç jeni ju, apo dhe në versione skandaloze nga botues piratë. Unë besoj që ky ligj, të paktën në një periudhë të parë që edhe të edukohet popullsia, konsumatori apo edhe botuesi, edhe vetë autori, edhe përkthyesi, duhet të jetë një ligj i fortë, sepse, për fat të mirë, në hallkën e botimit të librit, botuesi dhe shpërndarësi janë më të ndërgjegjshmit, sepse jeni profesionistë të fushës. Në fakt, për fat të keq, ata që e pësojnë janë krijuesit, të cilët as kanë mjetet për konsulencë juridike dhe as nuk e dinë deri ku mund të mbrohen dhe sa të drejta kanë nga akti i krijimit të tyre. Kështu që, në këtë kontekst, unë besoj se ky nen ka pasur parasysh pikërisht këtë gjë. Ndoshta në një dekadë të ardhshme mund të shikohet nga ligjvënësit apo përdoruesit e këtij ligji mundësia për ta ndryshuar, por për momentin, ky është një ligj në hapat e parë, i cili do kohën e vet të nevojshme për kolaudim në një treg totalisht xhungël, siç e gjetëm. Nuk po them që është rregulluar me futjen e ligjit në fuqi, por mekanizmat kanë filluar të veprojnë bashkë me sportelin unik, i cili, në fakt, nuk është publik, është sportel i agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit. Në fakt, do kohën e vet që kjo të stabilizohet dhe nuk e shoh të nevojshme që një ligj, i cili ende s'i ka dhënë provat e veta, të propozohet për ndryshim.

Bashkohem me ju 100% dhe është një gjë që e kam thënë edhe kur kam qenë ministre, edhe si deputete, që edhe unë e gjej shumë të rëndë tatimin prej 15% mbi të drejtat e interpretimit, dhe bëhet fjalë për një kategori njerëzish jo vetëm në fushën e librit, por edhe të gjinive të tjera të artit dhe të kulturës. Shqipëria është një vend i vogël, është një vend, i cili tranzicionin e ka pasur të gjatë dhe edhe më të gjatë e të vështirë në fushën e artit dhe të kulturës, për arsyen e thjeshtë se nuk kemi pasur traditë në tregun e artit, por ka qenë edhe politika. Më vjen keq, për njëzet e pesë vjet nuk ka qenë kultura prioritet, ka qenë në rënie të lirë dhe, nëse është mbajtur, është mbajtur falë inercisë së institucioneve që kemi trashëguar, siç është, po them, Teatri i Operës dhe Baletit, që është mbajtur falë talentit dhe forcës së vetë individëve të artit. T'i taksosh ata me 15%, ndërkohë që bëhet fjalë për një shumë të papërfillshme në buxhetin e shtetit në raport me disa fusha të tjera, sidomos, siç është libri, është e vështirë. Vërtet është vështirë për ta çarë tregun, artet pamore, për shembull.

Pra, në të gjithë këtë kontekst, unë mendoj që taksimi 15% është shumë i rëndë. Kam qenë kundër, jam kundër dhe nuk do të lodhem asnjë ditë që të luftojmë për ta ulur këtë kosto, që në finale shkon te kostoja e librit e bie në kurriz të lexuesit dhe rrit çmimin. Ne nuk kemi pse të shpikim rrotën, le të shikojmë se çfarë kanë bërë fqinjët rreth e rrotull e në vendet e tjera dhe besoj që nuk është e pamundur, përkundrazi, kërkon vullnet. Unë besoj që ky komision këtë vullnet duhet ta shprehë.

Lidhur me ankesën për pesë kopjet në Bibliotekën Kombëtare, ligji aktual i librit, po plotësoj të gjitha ato që nuk i tha zoti Ymeri, ka edhe një absurditet më të madh, ka kopjet e detyruara që çdo botues duhet të sjellë në Bibliotekën e Kuvendit, vendimi i vitit 2006. Vetëm kështu i kuptojmë problemet që kemi ose që nuk kemi. Po nuk e krahasuam se çfarë kemi evoluuar dhe si e kemi evoluuar, nuk kuptojmë se çfarë kërkojmë pastaj. Kjo gjë ishte absurde. Kemi qenë të gjithë dakord për këtë. Madje, në mos gaboj, ma konfirmoni, as nuk është zbatuar me rigorozitet, aq absurd ishte.

Krahasuar me referencat e shumë vendeve të tjera, 5 kopje i gjej të tepërta. Ka qenë një lloj kontributi që i kërkohej në mënyrë të detyrueshme botuesve, për të plotësuar fondet e Bibliotekës Kombëtare. Unë nuk jam për një, por për dy libra, duke iu referuar edhe vendeve të tjera perëndimore.

Ndërkohë, ajo që zoti Ymeri nuk përmendi është se prej një viti e gjysmë Ministria e Kulturës ka punuar për një projektligj të ri për librin, pjesë e konsultimeve të të cilit kanë qenë Shoqata e Botuesve, shoqata të tjera dhe aktorë të tjerë të zinxhirit të librit. Në fakt, për një insistim të Bibliotekës Kombëtare, më duket se në draft ka mbetur 5 kopje, por unë jam e mendimit që duhet të shkojë në 2.

Për TVSH-në për librin, në atë draft, i cili, në dijeninë time, i ka kaluar dyert e ministrive të tjera të linjës dhe, në mos gabo, ndodhet në derën e Ministrisë së Financës, propozimi që ka bërë Ministria e Kulturës në vitin 2018 është TVSH-ja zero.

E kam vullnetin individual për të thënë që i qëndroj kësaj, por besoj se ka mjaftueshëm hapësirë për të negociuar dhe për ta ulur, për të ndikuar në këtë mënyrë jo vetëm te botuesit, por pikësynimi im është drejt lexuesve dhe sidomos drejt popullarizimit të blerjes së librit në të gjitha format.

Dua të shtoj edhe diçka tjetër, që përsëri zoti Ymeri nuk e përmendi. Ky projektligj, në njëfarë mënyre, konfirmon edhe një vendim tjetër që ka marrë qeveria shqiptare në janar të vitit 2018, me një VKM të posaçme, për krijimin e Qendrës së Librit dhe të Leximit, në mos gabo, në 7 janar të 2018-s. Në dijeninë time, ky vendim ende nuk është jetësuar, por ka ngelur në letër. Unë pres me padurim që Ministria e Kulturës ta bëjë real këtë vendim. Nuk i di arsyet se përse nuk ka ndodhur deri tani, por në synimin e politikave të librit besoj se kjo tregon vullnetin e kësaj maxhorance, jo vetëm në të gjitha politikat që ka vënë në zbatim këta 6 vjet, por edhe në prioritetin që jep, duke krijuar një institucion të dedikuar për politikën, për promovimin e librit dhe të leximit, si aktivitet mbarëkombëtar dhe si një institucion që mund të ndërtojë një marrëdhënie më të posaçme me botuesit, autorët dhe shpërndarjen e librit shqip në gjuhë të huaj apo të librit të huaj në gjuhën shqipe.

Të mos harrojmë se ka 5 vjet që në Ministrinë e Kulturës janë ndërtuar 4 binarë shumë të rëndësishëm për politikën e librit, siç është fondi i dedikuar për përkthimin e librave më të mirë ndërkombëtarë nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe, janë rreth 150 tituj të botuar në këta 5 vjet me këtë fond, dhe nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj, rreth 30 tituj tashmë janë në gjuhë të ndryshme në Europë dhe përtej, falë këtij mekanizmi, si dhe fondi për krijimtarinë origjinale më të mirë, qoftë për letërsinë për fëmijë, së fundmi, qoftë për letërsinë për të rinjtë, qoftë për shkrimtarët e konsoliduar shqiptarë. Pa folur këtu për fondin e bibliotekave, duke filluar sadopak...

Unë e kuptoj që 25 vjet fonde të munguara në bibliotekat e bashkive nuk kompensohen dot me pak vite, por unë besoj se kjo mbledhje dhe sensibiliteti ynë ndikon te kryetarët e bashkive, të cilët, për fat të mirë, gjithmonë e më shumë, qoftë edhe me shembullin e shkëlqyer të Bashkisë së Tiranës, po e fusin në buxhetin e tyre vjetor librin, si një politikë kulturore e domosdoshme.

Ka filluar një lëvizje e tillë, sidomos në dy vjetët e fundit, duhet ta pranojmë. Ka një sensibilitet. Dua të përmend këtu bashkitë e Korçës, Tepelenës, Fierit, që i kam parë vetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...të cilat kanë futur më në fund... Kjo është një pasojë pozitive e të gjitha këtyre politikave të reja. Është shumë pak me nevojat dhe shumë pak për të garantuar të ardhmen, sepse kjo është një gjë që nuk duhet të ndalet.

Unë besoj se ne mund të nxisim që projektligji i ri për librin, që tashmë ka mbetur vetëm në derën e Ministrisë së Financave, me vullnetin e këtij komisioni të ecë para.

Ky ishte një përditësim që doja të bëja për shkak të detyrës që kam pasur, por edhe për t'i thënë disa gjëra të mira që janë bërë dhe na krijojnë një terren shumë të rëndësishëm për atë që vjen më pas.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni, zoti Ymeri!

Petrit Ymeri – E vlerësoj ndërhyrjen e zonjës Kumbaro dhe gjërat kryesore që përmendi.

Po e nis nga TVSH-ja. Është e vërtetë që Ministria e Kulturës është përpjekur bashkë me ne dhe kemi qenë në të njëjtën vijë mendimi për TVSH-në zero, por TVSH-ja zero na kthen në një marzh shumë të gjatë edhe më pas.

Edhe në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit, ku ka qenë zonja Milva nënkryetare, kemi diskutuar për TVSH-në dhe për gjëra të tjera.

TVSH-ja zero kërkon të bëhet zero në të gjithë sistemin, pra që nga materialet poligrafike, letra e të tjerë, sepse në qoftë se bëhet vetëm në gjysmën e sistemit, atëherë kjo rrit koston e librit.

Kemi folur gjatë edhe me zonjën Milva, që është e fushës së ekonomisë dhe i kupton edhe më mirë se ne këto gjëra.

E di edhe përkushtimin që ka pasur zonja Kumbaro për TVSH-në zero, por në këto kushte ku jemi, TVSH-ja 6%, kur e kemi 20% në blerje dhe 6% në shitje, është më e mirë se varianti 20 me 0. Ky shërben si një rregullator i sistemit, që ka pasur shumë probleme dhe shumë evazion fiskal qoftë nga operatorët e botimit, qoftë nga shtypshkrimet apo dhe shumë OJF, që janë aktorët kryesorë në botimet shqiptare, të cilat preken nga ky 6%-shi, sepse janë të detyruara ta deklarojnë në mënyrë më të rregullt veprimtarinë e tyre. Vendosija e TVSH-së pati një problem, por meqë unë shumë gjëra nuk i preka, se nuk doja të hyja, duke menduar se një pjesë juaja i njihni, hyri në mënyrë shumë të beftë, u miratua më 20 dhjetor dhe hyri në fuqi në 10 janar. Kjo krijoi një problem të madh, por tashmë kjo u kapërcye dhe le t'ia lëmë të kaluarës!

E thashë edhe qëparë që u bë një punë shumë e mirë në fillim të viteve 2000 me UNICEF-in, si dhe me disa furnizime në mes të viteve 2000 për bibliotekat shkollore. Unë kam biseduar shumë herë me Mirelën, me Lindita Nikollën për këto gjëra dhe i kuptojmë shumë

mirë hallet që ka vendi, por duhet luftuar me të gjitha format, që të tërheqim aktorë të fuqishëm të botës së biznesit, të institucioneve të rëndësishme, si UNICEF-i, ambasada të ndryshme, bankat etj..

Unë kujtoj që para dy vjetësh zonja Nikolla bëri një gjë të vogël nëpërmjet një banke, nuk po e përmend se cila, për një shumë fare të vogël, 30 mijë euro dhe ne, si Shoqata e Botuesve, i ndamë këto libra në 10 rrethe. Edhe pse ishte një gjë minore, la një gjurmë, sepse i çuam veçanërisht në rrethe periferike. Zonja Rista bëri një urim, por urimi më i mirë për ata nxënës do të ishte që bibliotekat, nuk po them të pasura, por të mos i kishin të varfra.

Para 3 vjetësh, me ndihmën e Ministrisë së Arsimit, kemi bërë një projekt shumë të mirë, 150 aktivitete librore në Tiranë, por edhe në rrethe, në fshatrat e largët të Gjirokastrës, të Sarandës, të Tepelenës, të Lezhës etj., ku gjendja e bibliotekave në shkolla është e mjerë në kuptimin e vërtetë të fjalës, si, për shembull, në mes të Vlorës, të Sarandës. Tani, kjo punë duhet zgjidhur nga shteti.

Jam dakord që të gjitha format që të çojnë te libri, pra nxitja e leximit, janë të mira. Tani nuk dua të replikoj për çështjen e ligjit “Për të drejtën e autorit”, i cili në pjesën me të madhe të tij është shumë mirë, por janë dy projekte të vogla që mund të diskutohen veç, sepse, me sa shoh, shumica e komisionit nuk i njeh këto probleme, për ta sjellë ligjin në nivelin europian, megjithatë nuk po hyj në detaje, sepse nuk është ky qëllimi. Pa dyshim që jemi për mbrojtjen e të drejtave të autorit, të të gjithë krijuesve dhe e them pa modesti, që luftëtari i parë i mbrojtjes të të drejtave të autorit në Shqipëri ka qenë Shoqata e Botuesve, e cila ka bërë të gjitha përpjekjet për instalimin e një sistemi që të mbrojë krijuesin, pra autorin, përkthyesin, ekzekutuesin, instrumentistin e kështu me radhë. E kanë bërë edhe shoqatat e tjera, por ne kemi qenë në ballë që nga viti 1992, kur Shqipëria nënshkroi Konventën e Bernës, madje kemi qenë iniciatorë të hartimit të parë të ligjit për librin.

Në radhë të parë, mbrojtja e autorit është detyrë dhe objekt i shoqatave profesionale dhe nuk mbrohet nga institucionet shtetërore, por nga ligji, sepse këtu ka një keqkuptim. Strukturat shtetërore përgatisin ligjet, i miratojnë, pastaj vepron ligji. Ka ligje, ka avokatë, ka juristë e kështu me radhë. Kështu funksionon në Europë dhe kështu duhet të funksionojë edhe këtu, prandaj dolëm kundër disa veprimeve radikale nga ISHMT-ja dhe këmbëngulim që Drejtoria e të Drejtës së Autorit duhet të jetë veçmas ministrisë, nuk duhet të ketë koracën shtetërore, pasi ajo ka ligjin bazë. Kush shkel ligjin, përballet në gjykatë me juristin. Kështu funksionon dhe kështu duhet të funksionojë. Megjithatë, nuk dua të replikoj për këtë çështje.

Gjatë këtyre viteve pa dyshim që janë bërë shumë të mira me punë për librin, por, siç e tha zonja Kumbaro, kemi një boshllëk shumë të madh për shkak të një dëmi që i është bërë

brezave për 30 vjet me radhë, e cila do disa dekada që të riparohet. Atëherë, shqetësimi ynë dhe i juaj është se si do të punojmë, çfarë do të bëjmë, çfarë masash do të marrim, çfarë projektesh do të bëjmë, që ta përmirësojmë këtë gjë? Se këto nuk janë gjëra që u vendosën sot dhe japin rezultat nesër!

Tani nuk dua të diskutoj për çështjen e kopjeve të detyruara. Europa e ka nga një apo nga dy kur ka dy biblioteka kombëtare, si, për shembull, Gjermania, e cila ka nga dy, një në bibliotekën kombëtare dhe një në bibliotekën e landit, meqë ka 5 *lande*; Italia ka dy biblioteka kombëtare dhe ka nga dy. Ne kemi propozuar, dhe kemi rënë dakord edhe me zonjën Kumbaro, që të ketë një kopje për Bibliotekën Kombëtare dhe një në bibliotekën e qytetit.

Tirana, për fat të keq, nuk ka bibliotekë qyteti. Meqenëse ju e morët si shembull pozitiv Tiranën, unë e quaj Tiranën si shembull negativ. Tirana nuk ka bibliotekë qyteti dhe nuk duket asgjekund ndonjë ide për të bërë bibliotekë qyteti. Tirana, për ata që e mbajnë mend, ka pasur bibliotekë qyteti.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ato janë biblioteka lagjesh.

Gjejmë lloj-lloj përbindshash që lindin në Tiranë, por bibliotekë qyteti jo.

Gjithashtu, furnizimi i bibliotekave të lagjeve është pothuajse inekzistent. Bëhen investime për ndërrimin e vetratave, të pllakave e kështu me radhë, por furnizime të bibliotekave të lagjeve nuk ka, me sa dimë ne. Në qoftë se bëhen furnizime për t'i bërë nder Gëzimit apo Petritit, tjetër punë, por furnizime publike që të deklarohen nuk bëhen, as në Fier, as në Berat, as në Tepelenë, as në Librazhd. Pra, nuk dimë që të bëhen furnizime të deklaruar, siç e ka ligji.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse Fieri e ka bërë një furnizim, duhet ta bëjë me shpallje publike, jo të marrë librat e shtëpisë botuese të zotit Gëzim Tafa apo edhe lagjes “x” të Tiranës. Furnizime të deklaruar të bibliotekave nuk ka.

Unë po marr një shembull, sa për të njohur gjendjen. Dje kam nxjerrë nga shtypi një libër, që unë e quaj të rëndësishëm, librin e Janis Riscos, të cilin e kam botuar në 400 kopje. Po ju them se 10 vjet më parë unë do të kisha botuar minimumi 1000 kopje. Në Shqipëri sot botohet letërsi shumë e mirë. Një e mirë e këtij produkti është niveli i lartë, mirëpo këta libra mungojnë në bibliotekat e shkollave, këta mungojnë në bibliotekat publike. Për kë punojmë ne? Ne punojmë për fëmijët, punojmë për të rinjtë, por nëse këto libra nuk shkojnë në destinacionin e duhur, çfarë boshllëku krijohet?

Nuk dua të diskutoj faktin se sa keq shkruajnë apo flasin nxënësit, që edhe kjo është rrjedhim i moslejimit, se nuk po them se sa keq flasin dhe shkruajnë mësuesit. Të zë paniku të marrësh një shkresë të ministrive dhe të shohësh se në ç'mënyrë janë konceptuar dhe shkruar. Të gjitha këto janë reflekse të mosleximit.

Ne po punojmë të gjithë së bashku, se nuk është puna t'i bëjmë karrshillëk njëri-tjetrit. Ne vijmë këtu për të ngritur disa probleme që janë shqetësimet tona. Në qoftë se ne botojmë një libër, kurse pas 10 vjetësh botojmë një libër me gati gjysmën e tirazhit, ose më pak se gjysma e tirazhit të 10 vjetëve më parë, atëherë ku jemi? A jemi në rrugë të drejtë? Nuk më duket se jemi në rrugë të drejtë. Më vjen keq që e them. Do të më pëlqente shumë të ishte e kundërta e kësaj që them.

Autorë të shkëlqyer, botime të përgatitura me të gjithë kujdesin e duhur, nuk janë në duar të lexuesve. Janë gjithnjë e më pak lexues që shkojnë në librari. Rrejt i librarive është rrudhur.

E tha edhe Mirela, duhet të ketë politika. Pushteti lokal duhet të bëjë politika. Po marr si shembull Fierin, që është rreth i fuqishëm dhe kam përshtypjen se kryetari është i gjindshëm, është punëtor, 5 vjet mund t'u heqë taksat librarive. Gjithashtu, theksoj se ligji i urbanistikës parashikon që në këto distanca mund të ngrihet një farmaci, një kopsht, por duhet të parashikohet edhe kur jepet leje ndërtimi për një librari, edhe për një bibliotekë lagjeje. Po këto nuk bëhen. Për fat të keq, ne jemi mësuar me këto gjëra.

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni, zoti Nikolla!

Qëndrimi juaj lidhur me problematikat e Shoqatës së Botuesve.

Nikolla Lera - Faleminderit!

Ministria e Financave gjatë gjithë kësaj periudhe 2-3 vjeçare ka pasur realisht në qendër të vëmendjes edhe problematikën e botuesve dhe të librit.

Ne kemi qenë në një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Arsimit dhe me vetë zonjën Kumbaro. Natyrisht, duke qenë apo duke mbuluar këtë fushë, Ministria e Arsimit ka qenë agresive në kuptimin e uljes së barrës fiskale mbi këtë sektor. Gjithsesi, Ministria e Financave është autoriteti që gjykon në tërësi sistemin tatimor, është autoriteti që nuk duhet të lejojë çarje të këtij sistemi, nuk duhet të krijojë precedentë për kërkesa të vazhdueshme nga grupe të tjera interesi, përtej librit apo përtej një sektori të caktuar, të cilat çojnë në gërryerjen e sistemit tatimor.

Ne jemi të ngurtë, sepse reduktimi i vazhdueshëm i taksave, heqja e vazhdueshme e taksave krijon precedentë negativë për ekonominë shqiptare. Është totalisht e ligjshme që një sektor të kërkojë incentiva, të kërkojë përjashtime, por këto incentiva dhe përjashtime nuk

mund të shtrihen në gjithë ekonominë e vendit. Kjo edhe lidhur me librin. Deri në fund të vitit 2018 ne e kishim librin të përjashtuar nga TVSH-ja. Pra, blerësi i librit, ai që konsumonte këtë produkt, nuk paguante TVSH. TVSH-ja që paguanin shtypshkronjat apo botuesit në blerjen e makinerive të letrës, të bojës e të tjera, e të tjera, ishte pjesë e kostos së tyre. Realisht, ishte kjo që ndodhte.

Atëherë, me kërkesën e vazhdueshme të Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Kulturës, në fund të vitit 2018 skema ndryshoi dhe nga një furnizim i përjashtuar, kaluam në një furnizim me TVSH 5 %. Pra, në pamje të parë duket se konsumatori i librit ngarkohet me plus 6 % TVSH, por ne kemi kalkuluar, kemi llogaritur dhe kemi shpërndarë të dhëna që argumentojnë se çmimi i librit jo vetëm nuk duhet të rritet, por duhet të ulët. Pse? Sepse 6 % mbi çmimin e shitjes së librit, që do t'i faturohet konsumatorit, është gjithmonë më e vogël se 20-përqindëshi që prodhuesit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, duhet të jetë më e ulët.

...nga sa prodhuesit paguajnë për blerjen e të gjitha imputeve të tyre për prodhimin e librit.

Pra, nuk ka asnjë arsye që çmimi i librit në treg të rritet. Përkundrazi, çmimi duhet të ulët. Problem i pazgjidhshëm ishte stoku në datën 31, por në çdo rast kur ndryshon ligji, është e pamundur të zgjidhen të gjitha çështjet e stokut, sepse nuk kishim as mundësi fizike e as mundësi teorike për të bërë inventarizimin e çdo libri, e çdo botimi në çdo cep të Shqipërisë, brenda një periudhe aq të shkurtër. Ajo ishte një fazë që nuk mund të rregullohej me ligj.

Ku jemi tani? Kemi një TVSH 6 % për librin. Edhe vendet e tjera të rajonit, edhe vendet e tjera të BE-së aplikojnë tarifën e reduktuar për librin, jo tarifën standarde. Ne, siç thashë, e kishim të përjashtuar. Tarifa e reduktuar varion nga 4, 5, 6, 7, 8, 9%. Ne kemi zgjedhur tarifën 6%. Nuk më duket e pranueshme që ne të shkojmë te tarifa 0 %. Përse duhet të shkojmë te tarifa 0%? Pse ne do t'i shumëfishojmë shitjet, po e ulëm me 6 % çmimin e shitjes së librit? Duhet të jenë mekanizma të tjera ato që duhet të stimulojnë shitjen e librit, jo thjesht stimujt fiskalë. Në qoftë se ne fillojmë e japim stimuj fiskalë, dhe unë e kuptoj se është shumë e rëndësishme për librin, do të kërkojnë edhe sektorë të tjerë. Ka sektorë të tjerë, si bujqësia, infrastruktura, arsimi e të tjerë, që në kuadrin e uljes së barrës së tyre fiskale do të shohin si rrugë heqjen e taksave, heqjen e tatimeve, të cilat kanë pasoja në financat publike të këtij vendi. Pra, nuk gjykoj se 6 % tarifë e reduktuar është ajo që do të zgjidhë çështjen e librit.

Ndërkohë, lidhur me tatimin për të ardhurat personale nga pronësia intelektuale apo nga e drejta e autorit. Janë të ardhura të vogla, u gjykua këtui, dhe tarifatatimore duhet të ulen në 15 %, 10 % apo 5 %.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, por ne kemi kërkesa të pafundme. Edhe një intelektual thotë: pse duhet të paguaj unë 23 % të pagës, sepse unë bëj punë intelektuale dhe s' duhet të paguaj. Edhe një punonjës i nivelit të mesëm thotë: pse duhet të paguaj 13 % tatim mbi pagën, duhet të paguaj më pak.

Pra, nëse ne shikojmë dhe marrim në konsideratë çdo kërkesë, atëherë sistemi fiskal do të deformohet. Ne kemi vendosur 15% për një kategori të caktuar të ardhurash personale, nga qiradhënia, nga interesat bankare, nga shërbimet teknike e të tjera. Nëse ne i ulim, i zerojmë, atëherë ky do të jetë një proces i pandalshëm dhe me pasoja në financat publike të këtij vendi.

Nuk e di nëse ka çështje të tjera. Në zbatimin e praktikave doganore jemi të prirë që t'i lehtësojmë, por nuk mund të injorojmë ligjin, Kodin Doganor. Lehtësimi i tregtisë me Kosovën, marrëveshjet që kemi nënshkruar për doganat e përbashkëta, do të çojnë drejt përmbushjes edhe të kësaj kërkesë të botuesve shqiptarë.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Mirela Kumbaro - Shumë faleminderit për sqarimet!

Unë e di që ju, si institucion, jeni “*miss dhe mister jo*”, sepse thoni “jo” për çdo gjë, se e keni në *job description* që të thoni “jo”. Prandaj e mirëkuptoj.

Në vijim të arsyetimit që bëri zoti Ymeri lidhur me TVSH-në, 5 vjet rresht u munduam që të bënim presion me mënyra joagresive, por nuk patëm rezultat. Duhej të ishim agresivë që të mbërrinim tek 6%-shi. Pra, kjo është një gjë e mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk thashë “unë”, por ishim agresivë. E bëri komisioni, po unë jam pjesë e këtij komisioni! Jam përballë Ministrisë së Financave, se nuk e kuptova ndërhyrjen.

Besoj se kemi bërë veprimin e duhur. Për sa i përket tatimit prej 15% , kjo nuk është më një çështje teknike, dhe ju falënderoj që jeni këtu për shpjegime teknike, por është një çështje e vullnetit politik, të cilin nuk e kërkoj personalisht nga ju, sepse me logjikën: “Po të bëjmë këtë, do të ngrihen edhe këta; po të bëjmë këtë, do të ngrihen edhe ata”, duhet që Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të qëndrojnë siç ishte në vitin 1990 dhe të mos bëjë gjë. Prandaj ka një evolucion, i cili shkon paralel me vullnetet politike në fusha të caktuara. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për turizmin, për të cilin kam qenë shumë partizane për ta bërë dhe ka dhënë efekte pozitive. Unë jam deputete në një qark që jeton kryesisht me bujqësi

dhe turizëm. 6% -shi i vendosur në sektorin e turizmit, ka qenë shumë nxitës për ekonominë në zonat e turizmit. Unë mendoj se kjo vështirësi për të parandaluar rrjedhjen në financat publike mund të rregullohet me ligj, duke e përcaktuar shumë qartë se cilat janë ato kategori kjo do të jetë pjesë e një debati të ekspertëve të Komisionit të Ligjeve dhe të ministrive të linjës, që kanë mirëfilli punë krijuese. Këtë kategori nuk e përkufizojmë ne, sepse e ka Franca, e ka Italia të përkufizuar shumë qartë. Kjo bëhet për të minimizuar efektin negativ, po e quaj, në financat publike, por për të përforcuar efektin shumë pozitiv për të sotmen dhe për të ardhmen, që nuk është më pak e rëndësishme sesa infrastruktura.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Po, zoti Ymeri.

Petrit Ymeri - Çështja e 6%-shit të TVSH-së është edhe çështje vullneti. Kur u miratua ligji, ne, të gjithë botuesit, u mbledhëm dhe vendosëm se si do të veprojmë. Të gjithë ata botues që e kanë futur 6%-shin në faturën e tyre, e kanë futur 6%-shin te vetja. Nuk e kanë vënë mbi çmimin e librit. Pra, e kemi futur brenda. Një pjesë e botuesve, për fat të keq, i kanë rritur çmimet, e kanë bërë 6%. Ata shesin më pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, i këtij viti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, ne kemi vendosur edhe stokun dhe jemi dëmtuar shumë. Kemi vendosur, pothuajse unanimitisht, që 6%-shin ta mbajmë në dëmin tonë. Pse?! E kuptojmë që, në fund të fundit, kjo është në dobi të lexuesve. Nëse do ta vëmë 6%-shin mbi çmimin e stokut, por edhe të librit të ri, atëherë dëmtohet. Kjo logjikë është: 6% -shi do të faturohet në dëm të botuesit, por kjo kthehet në dobi, sepse pothuajse ato ekuilibrojnë njëra-tjetrën, pra 20-ta me 6-ën. Tani për tani ky më duket sistemi më i mirë dhe ka dhënë rezultate të mira.

Së pari, sepse është rregullator, fut të gjithë sistemin. Ju e kuptoni më mirë se unë këtë gjë.

E dyta, ka dhënë rezultate pikërisht për këtë gjë: shtëpia botuese kur vendos këtë libër 800 lekë, kur ia jep librarisë, i vë 35%-shin dhe 6%-shin, 41% e vë në dëmin e vet, por kjo shton shitjet, duke parë situatën që kemi, që nuk është shumë e favorshme për lexuesit.

Fatjona Dhimitri - Ka pyetje?

Kostaq Papa - Përshëndetje!

Pavarësisht se çfarë diskutojmë këtu, ajo që duhet të theksojmë të gjithë është se libri është në emergjencë kombëtare. Po e kapim te fraza e ish-ministres, por do të donim që të gjithë ministrat t'i shprehin këto gjëra kur janë në detyrë dhe jo kur bashkohen këtu me ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e kam fjalën personalisht vetëm për ju.

Meqenëse kolegja po përshëndeste me radhë ministritë lidhur me problematikat dhe me fillimin e vitit shkollor, dua t'ju them se edhe me librat e shkollës ka problematika të mëdha. Dje kishte mungesa në librat shkencorë, në fletët e punës dhe në fletoret e modeleve. Edhe pse të gjithë urojnë një fillim të mbarë të vitit shkollor për 550 mijë nxënësit që hynë dje në shkollë, problematikat e librit shkollor janë të mëdha.

Dua të ndalem në përgjithësi te libri. Duhet të theksojmë të gjithë që çështja dhe gjendja e librit në këto 30 vjetët e fundit është në emergjencë kombëtare. Po përpiqem t'i ndaj këto problematika të mëdha, që ka trajtuar edhe herë të tjera zoti Ymeri dhe dua ta falënderoj për këto që ka bërë, në tri aspekte dhe për të parë që në të tria aspektet është shteti ai që ka ndikimin e tij kryesor:

Gjendja lidhur me bibliotekat dhe me sistemin zinxhir të bibliotekave dhe të institucioneve të tjera që merren me librin.

Problemet që kanë të bëjnë me të drejtat e autorit dhe të gjithë amalgamën e saj.

Sistemi fiskal dhe tatimor është i lidhur me të gjithë sistemin. Çfarë ndodh me librin nga shteti dhe doganat, të cilat pengojnë dhe ende libri shqiptar nuk është i lirë të lëvizë në kufirin shqiptar, por është peng i një sistemi fiskal, ligjor, doganor dhe tarifor, që nuk i përgjigjet realitetit dhe të vërtetës.

Po t'i shohim këto tri aspekte që unë ndava, dhe zoti Ymeri i ka ndarë në 7-8 gjëra, shohim që fillimi dhe fundi i gjërave që bëjnë pengesën ose vonesën e kësaj gjëje është shteti, i cili është elementi bazë për rregullimin, sidomos me çështjen e librit, i cili ka të bëjë me ne sot, me brezat nesër dhe me Shqipërinë e të ardhmen.

Fatjona Dhimitri- Përfaqësuesit e ministrisë.

Kozeta Angjeliu – Unë mendoj se problematikat e adresuara në drejtim të Ministrisë së Kulturës u ezauruan. Gjithsesi, unë po i përgjigjem pyetjes lidhur me krijimin e qendrës së librit dhe leximit, VKM-ja për krijimin e së cilës është miratuar në fillim të vitit 2019. Besoj që të gjitha procedurat kanë përfunduar dhe brenda shtatorit ajo do të jetë efiçente, do të jetë një institucion, një agjenci që do t'i japë një impuls të lartë fushës së leximit dhe librit.

Për sa i përket pjesës të së drejtës së autorit, jam plotësisht dakord me mendimin e zonjës Kumbaro për miratimin e ligjit të ri. Nuk e mendoj se është momenti të amendojmë edhe disa ndryshime të propozuara, pasi gjatë zbatimit të tij në vijimësi, mund të dalin edhe probleme të tjera.

Për sa i përket pjesës të të gjitha politikave të librit, Ministria e Kulturës vazhdon të ketë në prioritetet e saj 4 shtyllat e përmendura, ndërkohë që vazhdon të financojë 4 projekte: pasurimin e fondit të bibliotekave, ku që prej vitit 2014 ajo ka dhuruar për bibliotekat publike dhe bibliotekat e lagjeve rreth 5 mijë kopje. Mendoj se mund të jetë një promovim ndoshta më i intensifikuar, por nuk mendoj se ka të bëjë me një shpallje, pasi ato nuk i janë nënshtruar një procedure të një prokurimi për të pasur një shpallje ligjore.

Këto ishin problematikat lidhur me Ministrinë e Kulturës, të cilat zonja Kumbaro i ka ndjekur. Problematikat nuk adresohen vetëm për këto muaj, por për një periudhë shumë më të gjërë, për të cilat është përgjigjur Ministria e Kulturës dhe vazhdon t'i ketë në prioritetet e saj dhe të mbështesë shoqatën e lexuesve, leximin dhe librin.

Elira Dani – Jam drejtoreshë juridike në Ministrinë e Kulturës.

Për sa u takon disa çështjeve të aspektit ligjor, që u prekën nga Shoqata e Botuesve, ne kemi qenë gjithmonë të predispozuar për të implementuar, për sa i takon spektrit ligjor, të gjitha problematikat që i janë adresuar Ministrisë së Kulturës në fushën e librit.

Sot në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës është publikuar projektligji “Për librin”, ku janë pasqyruar disa nga kërkesat e Shoqatës së Botuesve, ku për kopjet e detyruara thuhet se 3 kopje të detyruara janë për Bibliotekën Kombëtare dhe 2 kopje për bibliotekat publike. Ne i kemi dëgjuar kërkesat e zotit Ymeri, por në bashkërendim me institucione të tjera të fushës së kompetencës, kemi rënë dakord për 3 kopje për Bibliotekën Kombëtare dhe 2 kopje për bibliotekat publike.

Për sa i përket çështjes së TVSH-së, ashtu siç e tha edhe zonja Kumbaro, ne gjithmonë kemi qenë të predispozuar për të implementuar gjithçka që Ministria e Kulturës ka në dorë për të rritur dhe për të dhënë një kontribut në fushën e librit, por janë disa çështje, të cilat nuk prekin fushën tonë të kompetencës, ato shtrihen më gjerë, siç është rasti i Ministrisë së Financave.

Në qoftë se sot do t'i referohemi projektligjit që është në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, Ministria e Kulturës ka kërkuar një çlirim në zero të procesit të blerjes së librit, ashtu edhe të shitjes së tij. Flasim për politika, të cilat janë gjithmonë në ndjekje. Për shembull, Qendra Kombëtare e Librit është në fazën e implementimit në strukturat e Kryeministrisë dhe shumë shpejt do të përfundojë, duke u ngritur si një qendër e re e dedikuar me burime njerëzore dhe financiare shtesë për librin.

Për sa i përket çështjes së të drejtave të autorit, është një ligj i ri, ende nuk i ka dhënë efektet e tij, prandaj le të presim, të shikojmë që të gjykojmë se si do të jetë ky implementim dhe çfarë të mirash do të sjellë në fushën e të drejtës së përkthyesve dhe më tej.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni!

Petrit Ymeri – Së pari, ka më shumë se një vit që flasim për ligjin e ri të librit, por ende nuk është zbardhur ligji i librit që të merret dhe të diskutohet. Ju jeni drejtoreshë Juridike dhe në mbledhjen e fundit të Këshillit të Librit kërkuam që të zbardhet ligji i librit, pra të shkruhet nga e para ligji i librit. Të shkruhet nga e para, të na shpërndahet dhe ta diskutojmë. Nuk bëhet me: “neni 3 ndryshohet, germa “b” apo germa “i” e kështu me rradhë. Të rishkruhet siç u bë me ligjin “Për të drejtën e autorit”, që u rishkrua. Koha kërkoi që ky ligj të ribëhet. Ne e kemi diskutuar disa herë me Ministrinë e Kulturës, kur ka qenë zonja Kumbaro ministre, por për disa gjëra jemi marrë vesh dhe për disa gjëra jo, siç bëhet gjithmonë. Por kështu duhet të ecni me ligjin e librit, sepse më pas do të mblidhemi përsëri dhe do të kërkojmë që t’i ndryshojmë gjërat.

Në asnjë mënyrë nuk do të pranojmë 3 kopje, kjo është kategorike. Në qoftë se do të vendosen 3 kopje, që të mos shkojmë në Gjykatën Kushtetuese, të mos shkojmë në Strasburg dhe të kërkojmë që të na paguani 5 kopjet e 30 vjetëve me radhë, ky quhet shpronësim. Ju që jeni juriste, e dini se çfarë do të thotë termi “shpronësim”? Kjo është një pasuri private e shtëpive botuese, të cilën shteti në asnjë mënyrë nuk ka të drejtë ta marrë me dhunën e ligjit.

Kemi 1 vit që presim të hapet Qendra Kombëtare e Librit. Nuk e dimë pse nuk po hapet dhe nuk dimë se çfarë do të bëhet. Është marrë vendimi, të punojmë, të diskutojmë, t’i themi gjërat. Nuk e dimë ende se çfarë po bëhet me Qendrën e Librit dhe se çfarë po bëhet me librin.

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni, zoti Nasufi!

(Diskutime pa mikrofon.)

Fjalën nuk mund ta merrni pa jua dhënë unë.

Fadil Nasufi - Kjo dëgjese me zotin Ymeri dhe me të tjerët ka një vlerë për ta sensibilizuar këtë problematikë, që është një plagë kombëtare. Kjo mund të krahasohet me kohën kur librat digjeshin në turrën e druve, para 3 shekujve, por edhe largimi i qasjes me librin është një shqetësim kombëtar. Kështu që, nuk po bëj më shumë komente sesa zoti Ymeri dhe zonja Kumbaro, të cilët e kanë ndjekur ligjin “Për të drejtën e autorit”, ligjin “Për botimet” dhe shumë politika të tjera kulturore.

Do të sjell përvojën e një çështjeje lokale, sepse është sa politikë kombëtare, aq edhe politikë lokale. Është politikë lokale, sepse ka të bëjë me faktin se bibliotekat sot janë të menaxhuara nga qeverisja vendore. Fatmirësisht, në Berat, ku kam qenë kryetar bashkie, kemi investuar rreth 50 milionë lekë të rinj për bibliotekën e qytetit, si godinë dhe, më pas, për ta pasuruar me fond librash. Vitet e fundit edhe TAP-i u bë pjesë e pasurimit të saj, të mobilimit.

Gjithashtu, krijuam edhe një rrjet donatorësh, siç kanë qenë TIKA, fondacioni “Saadi Shirazi”, USAID-i dhe disa shtëpi botuese, si: UEGEN, TOENA e me radhë. Kjo punë nuk mund të vazhdojë me bamirësi dhe me dhurata, por me politika të qarta financuese. Bashkitë duhet të vënë fonde për të pasuruar fondin e librit dhe për të ngritur komplet rrjetin e bibliotekave në shkolla, në grup-lagje e kështu me radhë.

I propozoj Ministrisë së Financave që, pavarësisht se ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” e detyron pushtetin vendor të jetë i pavarur në menaxhimin e të ardhurave të tij, t’i vërë kusht, siç na vinin ne, bie fjala, për gjelbërimin, që 10% e fondit të përdoret për gjelbërim. Po nuk i vure kusht dhe ta lësh në vullnetin e lirë të këshillit bashkiak, kur dihet se si e ka mendjen njëri kryetar, nuk e ka një tjetër, kjo punë nuk gjen zgjidhje as me thirrje patetike, as me vullnetin e lirë të drejtuesve vendorë. Pastaj, politikat kombëtare janë të piketuara në propozimet që ka sjellë zoti Ymeri këtu, por edhe në komentet që u bënë nga kolegët e tjerë deputetë.

E vërteta është kjo që, edhe po të pyesim njëri-tjetrin, ne dimë të bëjmë komente për kulturën virtuale që kemi nga rrjetet sociale, por të paktë janë ata që lexojnë libra, aq sa libri është hequr edhe si simbol i dhuratave; ia kanë zënë vendin bizhuteritë, parfumet, duke iu larguar kësaj kulture, që quhet një mbresëlënie, kur qarkullon në këtë formë. Pra, ka të bëjë edhe me kulturën në përgjithësi, por edhe me rrënimin që është krijuar në këta 30 vjet. Ndaj, duhet një ndërhyrje emergjente dhe të gjithë njerëzit që merren...

Unë nuk e di se çfarë sistemi kanë lëndët e letërsisë nëpër shkolla; si kontrollohet se sa lexon nxënësi letërsi të pavarur; a ka kartelë ose skedë të veçantë në bibliotekë ose jo. Kjo punë pothuajse rrjedh lirshëm dhe nuk ka sistem të qartë ose procedura të qarta detyruese të lidhjes së nxënësit me librin, të lidhjes së mësuesit me bibliotekën dhe të të gjithë shoqërisë, në mënyrë që të kulturohet dhe të mençurohet nëpërmjet librit dhe të gjithë rrjetit nga merr informacione dhe dije.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – E mbyllim tani seancën dëgjimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të kemi raste të tjera, ku do ta kemi përsëri të pranishëm zotin Ymeri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të kemi një seancë tjetër dëgjimore me ministren e Arsimit.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, do ta mbyllim, sepse zoti Ymeri ka punë, apo?...

Fatjona Dhimitri – Do t’i parashtrojmë të gjitha problematikat e Shoqatës së Botuesve.

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare...

Fatjona Dhimitri – Ju lutem, zoti Ismet, sepse edhe unë jam duke u larguar, pasi duhet të jem në Konferencën e Kryetarëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Do ta mbyllim mbledhjen, sepse keni ju punë, apo zoti Ymeri?..

Fatjona Dhimitri – Sikur nuk shkon të vazhdojmë ta kthejmë seancën dëgjimore në replika të vazhdueshme!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Ju lutem, sepse unë e kërkoja fjalën dhe mund të tërhiqem vetë gjatë diskutimit, por...

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni, çfarë kishit edhe ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Pra, diskutimi për librin ishte, me thënë të vërtetën, ka munguar në këto përmasa dhe me këto problematika që u diskutua sot. Por unë do të ndalem thjesht te shqetësimet dhe problematikat që ju ngrini.

Duke parë...

Fatjona Dhimitri – Zonja Ekonomi, do të vazhdoni ju?

Ismet Beqiraj – ...se e gjithë kjo logjistikë...

Fatjona Dhimitri – Ismet, edhe një herë, të kërkoj ndjesë që të ndërpres!

Ismet Beqiraj – Të lutem!

Fatjona Dhimitri – Gjithashtu, u kërkoj ndjesë për largimin tim zotit Ymeri, përfaqësuesve të Shoqatës së Botuesve dhe të ftuarve të tjerë, pasi më duhet të jem e pranishme në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve!

Ismet Beqiraj – Të lutem! Ç'është kjo, moj?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Mbledhja e komisionit do të vazhdojë nën drejtimin e zonjës Ekonomi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Le të largohet, le të kërkojë leje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem tani! Ç'është ky rregull?! Unë filloj nga diskutimi, ajo thotë!..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ju lutem!

Ismet Beqiraj – Nuk shkelet Rregullorja me ndjesa!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ismet, ju sqaroj unë: tani është mbledhja e Konferencës së Kryetarëve dhe kryetarja e komisionit duhet të jetë lart në mbledhje. Kështu që drejtimin e mbledhjes e marr unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fjala është për ju.

Ismet Beqiraj – Është interesante. Gjithnjë ma ndërpret fjalën kryetarja e komisionit, nuk e di se çfarë ka!...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta diskutojmë veçanërisht pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të ndalem te disa problematika.

Duke parë që ky shërbim edukativ dhe kulturor për të gjithë brezat ka një logjistikë që varet, me thënë të vërtetën, nga organet e vetëqeverisjes lokale, nga Ministria e Kulturës dhe nga Ministria e Arsimit, e shtroj pyetjen në mënyrë sugjeruese: mos ka ardhur koha të ndryshohet forma e menaxhimit të këtij shërbimi publik kombëtar me rëndësi?

Ju, me të drejtë, shpreheni se shkollat janë kthyer në një lloj bunkeri, ku mund të hyhet vetëm me leje të veçantë dhe me shumë këmbëngulje. Po kush i pengon?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më tej, me të drejtë, ka një postulat sa filozofik, aq edhe të drejtë që thotë: “Libri pa shkollën është i vdekur, por edhe shkolla pa librin është përsëri e vdekur”. Sinqerisht, ky është jo vetëm detyrim i të gjithë sistemit edukativ dhe institucioneve që ta fusim librin te nxënësit, nga më të vegjlit deri tek ata në moshë madhore, por sot ka një trend ku libri, biblioteka janë zëvendësuar nga *iPhone*-i, *Apple*-i... Si mendoni se mund ta tërheqim këtë brez nga kjo dukuri, që sinqerisht e përjeton çdo prind, vaj halli pastaj kontribuesit e sistemit të edukimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një shqetësim tjetër ka të bëjë me dukurinë e fotokopjimit masiv, sidomos në dyert e universiteteve. Pra, kemi një vjedhje të së drejtës legjitime të autorëve, të pedagogëve, të shkencëtarëve, të artistëve e të tjera. Por diku në shqetësimet që ngrini, thoni: “sugjerojmë që sektori i të drejtës së autorit në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut të suprimohet, meqenëse roli i tij është i pakuptimtë”. Mos shqetësimi, që është kombëtar, është kontradiktor me institucionin përkatës? Është ndryshe të vëmë në punë institucionin, ta rimodelojmë, duke bërë edhe ndryshimet përkatëse ligjore dhe nënligjore.

Meqenëse diskutohet edhe për zbutjen e detyrimit tatimor, unë e kam mbështetur plotësisht. Komisioni ynë e ka dhënë votën pa e diskutuar fare, por ama, edhe sikur të zerohet,

a përmirësohet situata? E rëndësishme është si të rikthejmë mikun e librit në të gjitha nivelet sesa të përmirësojmë kuletën e një botuesi.

Milva Ekonomi – Faleminderit, Ismet!

Unë mendoj se disave prej pyetjeve që ju shtruat, iu dha përgjigje më parë nga Ministria e Kulturës, nëpërmjet bërjes me dije të komisionit për vendimin e Këshillit të Ministrave për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Leximit.

Për sa i përket Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, janë detyra që lidhen ngushtësisht me të drejtën e autorit dhe, mbase, ministria mund ta sqarojë pak më tepër se çfarë ndodh.

Unë besoj se këto shqetësime që ka sjellë Shoqata e Botuesve do të jenë shqetësime të përhershme të komisionit edhe në muajt në vazhdim. Pra, do të kemi përsëri një diskutim kur të vijë momenti i buxhetit dhe i paketës fiskale. Unë besoj që pa u shteruar të gjitha diskutimet që ka në nivel teknik për çështjen, të mos bëhen çështje të komisionit, sepse ne nuk ndihmojmë dot, nëse nuk lëmë të flasim teknikët më parë.

Nuk e di nëse kolegët kanë diçka për të shtuar.

Adelina Rista – Zonja Ekonomi, unë kam thjesht një falënderim.

Të fillosh komisionin me një dëgjese për problemet me librin, në ditën e dytë të fillimit të shkollës, sapo ka filluar viti mësimor, dhe ta kthesh të gjithë vëmendjen e komisionit te problemet që ka libri, sinqerisht është për t'u falënderuar. Çdo dëgjese ka rëndësinë e vet, por zgjedhja e kohës kur do të bëhet dëgjesa shton te ne ndjeshmërinë.

Shumica prej nesh këtu i përkasin brezit që e ka pasur librin si të vetmin mjet burimi informacioni dhe me të cilin kemi pasur marrëdhënie të ngushtë. Sot ka hyrë teknologjia. Kështu që, prandaj them që ndjeshmëria është tepër e lartë.

Unë mendoj se ne, si komision, duhet të qëndrojmë te të gjitha problematikat që ngriti Shoqata e Botuesve. Le të themi se kjo dëgjese shërben si sensibilizim për të gjitha institucionet që punojnë sot me librin, duke filluar nga shkollat, te mësuesi, për pasurimin e bibliotekave shkollore, që nga drejtoritë e shkollave, që nga mësuesi që punon direkt në bibliotekën e shkollës, nga mësuesi i klasës së parë, për mënyrën si e ofron te nxënësit dashurinë, jo vetëm për librin mësimor, por edhe të tjerë, me qëllim që nxënësit të zgjerojnë njohuritë, që nga institucionet vendore, bashkitë, të cilat kanë në buxhetet e tyre buxhetin për bibliotekat e deri te ministritë përkatëse. Gjithashtu, le të shërbejë kjo dëgjese si një sensibilizim për sjelljen sa më parë të projektligjit “Për librin” edhe këtu te ne.

Dua të them që ligjet nuk janë statikë, por dinamike. Në një kohë të caktuar, kur shikohet se çfarë të rejash dalin, sepse koha gjithmonë ecën, bëhen edhe ndërhyrje, por

gjithmonë duhet gjetur koha dhe momenti kur të bëhen. Në një ligj të ri, që sapo është futur, nuk besoj se duhet ndërhyrë menjëherë. Le të shikojmë çfarë do të sjellë në ecurinë e vet.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, Adelina!

Zoti Ymeri, ne do të kemi një dëgjësë edhe me ministren e Arsimit. Të gjitha shqetësimet dhe sugjerimet që ju keni, për të shtrirë edhe më tej shërbimin e leximit nëpër shkolla, do t'ia prezantojmë ministres dhe do të presim një reagim nga Ministria e Arsimit.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 11:40

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi i kalendarit të punës së Komisionit.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Fadil Nasufi, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ramazan Gjuzi, Kostaq Papa, Selami Jehnishehri dhe Amra Barova.

Mungojnë:

Vilma Bello, Enada Kapllani, Klajdi Qama.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Kolegë, para se t'u japim të drejtën për t'u larguar të ftuarve, dua t'ju kujtoj që duhet të rrimë edhe pak për të vendosur për kalendarin.

Gjithashtu, dua që të gjithë së bashku t'i urojmë mirë se ardhjen në një detyrë të re zotit Ramazan Gjuzi, si nënkryetar komisioni, që nga mbledhja e sotme.

Ju faleminderit shumë!

(Diskutime pa mikrofon.)

Miq, ju e patë që Ariana na ka lënë të gjithëve rendin e ditës për sot. Disa gjëra janë kujtesë.

Kemi seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, ku u la që të komunikim me ministren. Të mos harrojmë që java që vjen është “Java e Gjelbër”. Kështu që, koha më e afërt që ka për të ardhur është java e parë e tetorit. Pasi diskutuam me ministren, nga axhenda që ka, ajo e shikon të mundshme në datën 2 tetor, pas mbledhjes së qeverisë, edhe pse ne e kishim lënë në datën 30 shtator.

Kështu që mbase 30 shtatorin mund ta negociojmë me Ministrinë e Financave për arsimin profesional. A mendoni se është më mirë të fillojmë me arsimin profesional?

Jo? Adelinës nuk i pëlqen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, e kam për çështje kohe.

Ndërkohë kemi këto të tjerat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I bëjmë një ditë, njëra pas tjetrës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, e kuptova qëllimin tuaj të mirë.

Kemi një pikë tjetër që lidhet me dy projektligje, të cilat do të diskutohen në seancë në datën 17 tetor. Kalendar i punës së komisionit është 3-javor. Në javën që fillon me 30 shtator ne kemi tri mbledhje: të hënën, të martën dhe të mërkurën. Edhe javën e dytë, që fillon me 7 shtator, kemi përsëri mbledhje të hënën, të martën dhe të mërkurën, dhe kjo është java kur duhet të dorëzojmë raportin, sepse kërkohet të dorëzohet 4 ditë përpara. Ne mund të shfrytëzojmë edhe ditën e premte, sepse kjo ditë mund të jetë më e lirë tani që është vendosur edhe Java e Gjelbër.

Kemi për të zhvilluar disa dëgjesa. Unë diskutova edhe me këshilltarin tonë juridik dhe vendosëm të thërrasim në dëgjesa AMA-n, tri shoqata gazetarësh, sindikatën e gazetarëve, AKEP-in dhe Institutin e Medies. Ndërkohë, unë kam vënë me pikëpyetje nëse është mirë të thërrasim për dëgjesë përfaqësuesit e RTSH-së. Pra, shikoni sa shumë dëgjesa kemi: 7 dëgjesa, përpara se të kalojmë te ligji! A t’i bëjmë për tri ditë, pra ta ngjeshim pak kalendarin e punës për dëgjesat? Nëse jeni dakord, unë do të shoh bashkë me Fidelin dhe Ramazanin kalendarin e dëgjesave për këto javë, që të kemi mundësi të punojmë. Ju kujtoj që kemi dëgjesën me ministren e Arsimit dhe zëvendësministren e Financave, kështu që unë do të bëj një kalendar dhe do t’ju shpërndaj. A jeni dakord, se këto na kanë dalë tani në kalendar, nuk i kishim më parë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord për 30 shtatorin, por duhet të bëhemi gati ndërkohë, sepse pas 30 shtatorit angazhimi ynë, në dy javët që vijnë, do të jetë maksimal dhe duhet të mendojmë edhe për një relator. Nuk e di a do të ketë një relator nga pala juaj, se zakonisht nga pala jonë ne caktojmë Musain si relator.

Po, fjala për ju.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja kryetare!

Programi i punës është bërë gjithmonë nga kryetarja, nga ju, si nënkryetare, dhe nga sekretari dhe ne kemi qenë dakord, por u them kolegëve me shumë dashamirësi që t'i studiojnë mirë materialet që marrin, në mënyrë që të mos flasin gjatë këtui.

Milva Ekonomi - Shumë shkurt, do t'ju kujtoj edhe një gjë tjetër: Ariana na ka shpërndarë me *e-mail*, dhe e kemi edhe sot në dosje, ftesën për pjesëmarrje në një aktivitet që organizon Autoriteti i Medieve Audiovizive, konferencën me temë “Radio fetare në gjuhën shqipe”, në datën 2 tetor 2019, në orën 9:30, në hotel Rogner.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është në 2 tetor, pas mbledhjes së qeverisë, pra pas orës 11:30.

Fideli do të shkojë te hotel Rogner në datën 2 tetor, në orën 9:30, ditën e mërkurë? Pyes, sepse dëgjesën me ministrin e kemi pas mbledhjes së qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe Bujari? Dakord.

Mirë, e vendosëm edhe këtë. A kemi ndonjë çështje tjetër, që na ka ngelur pezull nga sekretaria? Nuk kemi.

Atëherë urime edhe njëherë zotit Ramazan! Mirë se na u bashkove!

Suksese!

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA